REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT - TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 168/17
Datë/Datum 02.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Kuvendi Komunal Gjakovë

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *632-17-1293-2-2-1*

Sa i përket tenderit për : Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"Group For Security" sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Tringë Smjali Nr.60, Prishtinë
(Adresa)
Prishtinë, Kosovë
(Vendi)
[redacted]8
(Numri Telefonit)

10000
(Kodi postar)
N/A
(Numri i Faks-it)

Shkumbin Rashiti
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
[redacted]
(Adresa elektronike)

31.05.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Security Company "GFS" SH.P.K. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 61- Tenderët Jo-Normalisht të Ulët (LPP)
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (LPP)

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. Në sqarimet e dhëna në platformën elektronike, AK-ja ka kërkuar që paga mesatare për një punëtor të jetë në shumë prej 300.00 €, kurse OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e plotëson kërkesën e AK-së, me këtë rast AK me përgjigjet e dhëna gjatë sqarimeve nuk i ka respektuar kërkesat e saj dhe në këtë mënyrë i ka lajthitur OE-të tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, ku edhe ka rekomanduar për kontratë OE që nuk e plotëson këtë kriter. **Lollgaritja: 300.00 € x 26 punëtor = 7800.00 € x 12 Muaj = 93,600.00 € + 18% TVSH =110,448.00 €**
Pra, nga kalkulimi shihet se oferta nga OE (EUR 109,900) nuk mund të plotësoj kriterin e kërkuar për pagesën e pagës EUR 300.
Ne jemi bazuar në kërkesat e AK duke rrespektuar kuotën/shumën prej 300.00 € dhe respektimin e Ligjit të Punës kërkuar nga AK ku parashihet në dokumentacionin e tenderit *(Aneksi 1 –Specifikime Teknike të Detyrueshme)* Kompania është e obliguar që të ofroi pagën bruto mesatare sipas standardeve dhe legjislacionit në Kosovë (Me të gjitha taksat e aplikueshme në RKS) duhet të parashihet edhe ndërrimi i natës, pushimi vjetorë, si të drejta elementare nga Ligji i Punës 03/L-212 për 26 punëtorët e kërkuar.
Pagesat shtesë sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 ,Nenit 56- Paga shtesë:
1.Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.

2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:

2.1. 20 % në orë për kujdestari;

2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;